



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 6, dt. 17.06.2019

**MBI MIRATIMIN E DOKUMENTIT PARAPRAK TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2020-2022 PËR KËSHILLIN E QARKUT**


Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, te Ligjit Nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit nr. 7 dt. 27.02.2019 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2020-2022”, si dhe të Vendimit të Keshillit të Qarkut nr. 01 date 13.03.2019 “Mbi miratimin e taveve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë dokumentin paraprak të Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 për Këshillin e Qarkut Korçë të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
2. Të miratojë relacionin shpjegues për procesin e përgatitjes së dokumentit paraprak të Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Menaxhimit Strategjik dhe Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI PËRGATITJEN PARAPRAKE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2020-2022 PËR KËSHILLIN E QARKUT KORÇË

Me urdhër të Kryetarit të Keshillit të Qarkut nr. 52 dt. 19.12.2018 u ngrit grupi i punës, “Për Menaxhimin Strategjik (GMS)”, në kuadër të hartimit të PBA-së 2020-2022. GMS në punën e tij është mbështetur në kalendarin e hartimit të programit buxhetor afatmesem 2020-2022, i cili është miratuar me vendim të Keshillit të Qarkut nr. 15 date 11.12.2018.

Ekipi për menaxhimin e programeve përgatiti dhe paraqiti për miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesem në nivel programi.

Keshilli i Qarkut Korçë me Vendim nr. 01 date 13.03.2019 ka miratuar tavanet përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesëm 2020-2022.

Grupi i punës përgatiti raportet e shpenzimeve në nivel programi duke paraqitur projekt dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022, i cili pritet të kalojë për miratim në Keshillin e Qarkut në periudhën në vazhdim sipas kalendarit të aktiviteteve.

Grupi i punës në procesin e hartimit të dokumentit paraprak të Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022, ka patur si synim realizimin e misionit të Keshillit të Qarkut në drejtim të hartimit dhe zbatimit të politikave rajonale, harmonizimin e tyre me politikën e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Keshilli i Qarkut ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale për pjesëmarrje në projekte gjithë përfshirëse. Keshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarrje në Programet nderkufitare të financuara nga Bashkimi Europian dhe organizata të tjera me synim zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit dhe rritjen e cilësisë të shërbimeve për komunitetin.

Keshilli i Qarkut ka publikuar në faqen e tij zyrtare tavanet përgatitore për Programin Buxhetor Afatmesem 2020-2022 të miratuara me Vendim nr. 1 date 13.03.2019.

Informacion financiar

Burimi i të ardhurave

1. Të ardhurat gjithsej

Në mijë lekë

2017	2018	2019	2020	2021	2022
90415	115291	140354	72992	78912	84811

Në vitin 2019 të ardhurat gjithsej përbëhen nga 52550 mijë lekë të ardhura nga transfertat e pakushtëzuar, 7800 mijë lekë nga të ardhurat e veta, 6715 mijë lekë nga transfertat për DAMT-në si dhe 73289 mijë leke të trashëguara nga periudhat e mëparshme. Niveli i lartë i fondeve të trashëguara lidhet me faktin që institucioni ka disa vite që planifikon fonde për pjesëmarrje në programet e Bashkimit Europian, dhe në vitin 2018 filloi implementimi i këtyre prej tyre, financimi i të cilave do të vazhdojë në periudhën e ardhshme.

Për tre vitet në vazhdim në planifikimin e të ardhurave janë marrë në konsideratë nivelet e transfertes së pakushtëzuar të planifikuara për tre vjet në udhëzimin përkatës, si dhe një parashikim i të ardhurave të vet institucionit që përbehen nga tarifatat dhe kontributi financiar i bashkive. Për transfertën e kushtëzuar (buxheti i DAMT) është llogaritur një rritje e vogël për tre vitet.

2. Të ardhura tatimore nuk ka.

3. Të ardhurat jo tatimore

Në mijë lekë

2017	2018	2019	2020	2021	2022
1731	1434	7800	7386	8051	8695

Planifikimi i bërë për vitin 2020 në vlerën 7386 mijë lekë përfshin të ardhurat nga tarifatat administrative 1386 mijë lekë dhe të ardhurat nga kontributet e bashkive 6000 mijë lekë të cilat sipas Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nëni 38/3, tashmë vendosen me vendim të këshillave përkatës të këtyre bashkive. Planifikimi nga ana jone i kontributit financiar të bashkive i është referuar planit të tre viteve parardhëse, pavarësisht realizimit të tyre, që është në nivele të ulta dhe nuk varet nga Institucioni. Për planifikimin e të ardhurave nga tarifatat në 3 vitet e ardhshme të PBA-së jemi mbështetur në realizimin e të ardhurave në vetet e kaluara, duke parashikuar një rritje rreth 10%. Në trendin e rritjes së këtyre të ardhurave nuk është përzgjedhur dhe nuk mendohet të ndikojë ndonjë prej faktorëve makroekonomikë.

Në zbatim të Instrumentit të Planifikimit Financiar, Këshilli i Qarkut në dokumentin paraprak të PBA 2020-2022 ka planifikuar 5 programe buxhetore.

Informacion për programet Buxhetore

011: Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin; ai siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun.		
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Administrim, operim ose mbështetje e zyrës së kryetarit të njësisë vetëqeverisjes vendore ose këshillit dhe komisioneve të këshillit ose të kryetarit të njësisë. • Komunikim i kryetarit ose këshillit me publikun.

Të dhënat e programit ¹	2017	2018	2019	Trendi
Këshilli i Qarkut (Aparati)	13	13	13	

Informacion financiar ²						
	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tavani i përgjithshëm i programit				52912	54202	57140
Shpenzimet bruto	32375	41403	71225	52912	54202	57140

Të ardhurat e programit	1731	1434	7800	7386	8051	8695
Shpenzimet neto	30644	39969	63425	45526	46151	48445
Pagat dhe sigurimet shoqërore				30790	30790	30790

¹Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohë të plotë e kohë të pjeshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3,ç)

²Për informacionin financiar për çështjet e mëposhtme, shko te Kërkesat Buxhetore dhe IPF përkatëse dhe nxirr informacion nga kutitë si më poshtë:

Investimi kapital	0	0	21000	10000	10000	12000
-------------------	---	---	-------	-------	-------	-------

042: Bujqesia Programe IPA - Projekti WINCOME

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Objektivi i përgjithshëm i projektit WINCOME është "Përmirësimi i kapaciteteve ndërkufitare për të mbështetur sipërmarrjen, mbijetesën e biznesit dhe konkurrencën, në aspektin e prodhimit dhe shfrytëzimit të verës dhe shkëmbimit të njohurive lidhur me prodhimin e verës dhe vreshtarinë, zhvillon shërbime mbështetëse të biznesit për të mbështetur aktivitetin ekonomik ndërkufitar, si dhe shërbime që nxisin prodhimin e verës		
04220	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> Shpenzime per bashkefinansim ne Projekti Wincome, Programe IPA financiar nga fonde te Bashkimit European dhe ne partneritet me Bashkine Zitsa, Greqi Shpenzime per financimin e TVSH ne projekti.

Të dhënat e programit ³	2017	2018	2019	Trendi
Këshilli i Qarkut (Aparati)				

Informacion financiar ⁴						
	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tavani i përgjithshëm i programit				650		
Shpenzimet bruto			2455	650		

Të ardhurat e programit						
Shpenzimet neto			2455	650		

³Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohëtëplotë e kohë të pjesshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3,c)

⁴Për informacionin financiar për çështjet e mëposhtme, shko te Kërkesat Buxhetore dhe IPF përkatëse dhe nxirr informacion nga kutitë si më poshtë:

Pagat dhe sigurimet shoqërore				650		
Investimi kapital	0	0	0	0	0	0

051: Menaxhimi I mbetjeve Programe IPA - Projekti Waste Rreact

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
<p>Objektivi i përgjithshëm i projektit WASTE RREACT është : "Promovimi i rrjeteve të qëndrueshme të transportit, informimit dhe komunikimit shërbime dhe investime në ujrat ndërkufitare, mbetjet dhe sistemet e energjisë dhe objektet '.</p> <p>Objektivat e tjerë të projektit përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i problemeve dhe joefikasitetit të përbashkët dhe krijimi i mundësive të shkëmbimit dhe bashkëpunimit • Promovimi i pjesëmarrjes, vetëdijes publike dhe përfshirjes së palëve të interesuara në nivel lokal dhe rajonal • inkurajimin e transferimit të teknologjisë, njohurive dhe praktikave më të mira për menaxhimin e mbeturinave në riciklimin dhe kompostimin midis 7 rajonëve dhe promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar • Promovimi i krijimit dhe funksionimit të infrastrukturave dhe nismave inovative si pikat e gjelbra (riciklimi), impiantet e kompostimit, mbledhja e ndarë • Forcimi i zbatimit të politikave të BE, kombëtare dhe rajonale për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e mbeturinave 		
05100	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Shpenzime per bashkefinansim ne Projekti Waste Rreaci, Programe IPA financuar nga fonde te Bashkimit European dhe ne partneritet me Rajonin e Epirit, Greqi • Shpenzime per financimin e TVSH ne projekti.

Të dhënat e programit ⁵	2017	2018	2019	Trendi
Këshilli i Qarkut (Aparati)				

Informacion financiar⁶

⁵Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohëtëplotë e kohë të pjesëshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3,ç)

⁶Për informacionin financiar për çështjet e mëposhtme, shko te Kërkesat Buxhetore dhe IPF përkatëse dhe nxirr informacion nga kutitë si më poshtë:

	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tavani i përgjithshëm i programit				1200	200	
Shpenzimet bruto			3825	1200	200	

Të ardhurat e programit						
Shpenzimet neto			3825	1200	200	
Pagat dhe sigurimet shoqërore				1200	200	
Investimi kapital	0	0	875	0	0	0

063: Furnizimi me Uje Programe IPA - Projekti Save Water

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit		
<p>Objektivi i përgjithshëm i projektit SAVE-WATER është rritja e kapacitetit të infrastrukturës ndërkufitare në menaxhimin e ujit përmes planifikimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës së furnizimit me ujë në një përpjekje për të përmirësuar sistemet e monitorimit të cilësisë së ujit të pijshëm dhe për të rritur efikasitetin e menaxhimit transnacional.</p> <p>Objektivat kryesorë të Projektit janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1-Rrjetëzimi transnacional për njohjen, hartimin dhe vlerësimin e të ujit të pijshëm. 2-Rritja e menaxhimit efikas të infrastrukturës së ujit të pijshëm përmes teknologjive të monitorimit të zgjuar me kosto të ulët dhe mjeteve me porosi vendim-marrëse. 3-Vendosja e Strategjive Transnacionale, Planit të Veprimit dhe Mjeteve për menaxhimin efektiv dhe efikas të ujit të pijshëm midis vendeve kufitare. 4 - veprime pilot konkrete nëpërmjet transferimit të praktikave më të mira dhe kapitalizimit të rezultateve të projektit për nxitjen e rritjes financiare dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore. 		
06330	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Shpenzime për bashkefinansim në Projektin Save Water, Programe IPA financuar nga fonde të Bashkimit Europian dhe në partneritet me Rajonin e Ishujve Joniane, Greqi • Shpenzime për financimin e TVSH në projektin.

Të dhënat e programit ⁷	2017	2018	2019	Trendi
Këshilli i Qarkut (Aparati)				

Informacion financiar ⁸						
	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tavani i përgjithshëm i programit				18030	24510	9671
Shpenzimet bruto			59179	18030	24510	9671

Të ardhurat e programit						
Shpenzimet neto			59179	18030	24510	9671
Pagat dhe sigurimet shoqërore				147		
Investimi kapital	0	0	52636	16093	16990	18000

063: Furnizimi me Uje Programe IPA - Projekti Save Safe Water

Struktura përgjegjëse

Vështrim i përgjithshëm i programit
<p>Synimi kryesor i SaveSafeWater është rritja e kapacitetit të infrastrukturës në menaxhimin e ujit përmes rrjeteve efikase për furnizim të ndërsjelltë midis vendeve kufitare në drejtim të një mjedisi jetësor të vlefshëm. Kjo do të arrihet përmes:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përshtatja e një kornize të përbashkët metodologjike për menaxhimin e burimeve ujore (cilësore dhe sasiore), aktivitetet natyrore dhe njerëzore dhe zvogëlimin e ndjeshmërisë së burimeve ujore. 2. Rritja e efikasitetit të përdorimit të ujit , përmirësimi i cilësisë së ujit dhe sigurisë në të gjithë zingjirin e ujit të pijshëm, nga burimet ujore në rrjetin e shpërndarjes së ujit dhe prapa në mjedis nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të parametrave të cilësisë së ujit në kohë reale dhe disinfektimit në linjë për të zvogëluar rrezikun e mbetjeve të ulëta të klorit & përqendrimet të tepruara të THM (substancave toksike që shkaktojnë kancer) .

⁷Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohëtëplotë e kohë të pjesshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3.ç)

⁸Për informacionin financiar për çështjet e mëposhtme, shko te Kërkesat Buxhetore dhe IPF përkatëse dhe nxirr informacion nga kutitë si më poshtë:

4. Rritja e përdorimit të teknologjive të reja përmes menaxhimit të integruar të burimeve ujore përfshirë aplikacionet e bazuara në GIS; modelet e simulimit hidraulik dhe sistemet e mbështetjes së vendimeve.

06330	Planifikim, menaxhim dhe administrim	<ul style="list-style-type: none"> • Shpenzime për bashkefinansim në Projektin Save Safe Water, Programe IPA financuar nga fonde të Bashkimit Europian dhe në partneritet me Institutin e Basenit të Ujit Janine, Greqi • Shpenzime për financimin e TVSH në projekt.
-------	--------------------------------------	---

Të dhënat e programit ⁹	2017	2018	2019	Trendi
Këshilli i Qarkut (Aparati)				

Informacion financiar ¹⁰						
	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tavani i përgjithshëm i programit				200		
Shpenzimet bruto			1773	200	0	0

Të ardhurat e programit						
Shpenzimet neto			1773	200	0	0
Pagat dhe sigurimet shoqërore						
Investimi kapital	0	0	0	0	0	0

⁹Informacion për të dhëna specifike të programit, sidomos numri i stafit me kohë të plotë e kohë të pjesshme, informacion për vendorin, pajisjet teknike etj. (LFV, neni 40,3,ç)

¹⁰Për informacionin financiar për çështjet e mëposhtme, shiko të Kërkesat Buxhetore dhe IPF përkatëse dhe nxirr informacion nga kutitë si më poshtë:

Detyrimet e prapambetura

Stoku i borxhit deri në 31.10.2019 në total llogaritet në vlerën 5489 mijë lekë, por këtu ka vend të sqarojmë për prejardhjen e këtyre detyrimeve. Së pari Këshilli i Qarkut nuk trashëgon fatura të prapambetura nga furnitorë aktuale të pas vitit 2013. Detyrimeve të trashëguara i takojnë periudhës 2007-2012 kur Këshilli i Qarkut ka patur veshtirësi financiare për shkak të uljes së ndjeshme të Grantit me rreth 35 % të pajustificuar me ulje të funksioneve. Gjithashtu Këshilli i Qarkut ka detyrime për disa vendime gjyqësore në vlerë 3.4 milion leke. Janë marrë masat që amortizimi i detyrimeve të trashëguara të bëhet brenda këtij Programi buxhetor.

Veç detyrimeve të sipërpërmendura ka ende disa vendime në proces gjyqësor që janë apeluar në Gjykatën e Apelit Korçe dhe Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, për të cilat nuk mund të parashikojmë një detyrim konkret por në përputhje me Shtojcën nr.5 të Udhëzimit të buxhetit do të pasqyrohen si detyrime të krijuara rishtazi.

Konkluzione

Ky program buxhetor afatmesëm 2020-2022 përmban tavanet përgatitore të të ardhurave dhe shpenzimeve, për këtë periudhë. Në këtë program janë mbajtur parasysh kërkesat e UMF Nr. 23 dt. 22.11.2016 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm" dhe UMF Nr. 07 date 27.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022". Në planifikimin e të ardhurave të veta, për periudhën 2020-2022, GMS u mbështet në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.68, datë 24.04.2017 "për financat e vetëqeverisjes vendore", duke mbajtur parasysh:

1. Realizimin e të ardhurave nga kuota e antarsisë nga shtatë bashkitë përbërse të Qarkut për vitin 2018 dhe të pritshmin e vitit 2019.
2. Realizimin e të ardhurave nga shërbimet që ofron Këshilli i Qarkut.

Ky Program Buxhetor, pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar, të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që qarku do të ketë në dispozicion, për të financuar shpenzimet e tij. Në shpenzimet e planifikuara, janë mbajtur parasysh shpërndarja e tyre sipas programeve buxhetore, ku janë parashikuar shpenzimet për administratën e Këshillit të Qarkut dhe Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, si dhe shpenzime në kuadër të pjesëmarrjes në Programet IPA Cross Border 2014-2020, nga të cilat ka filluar implementimi i këtyre Projekteve me partnere rajonale e nderkufitare.

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve institucioni ka përcaktuar tavanet e të ardhurave dhe shpenzimeve të PBA-së. Në parashikimin sipas programeve, GMS pati parasysh:

- Planifikimin e investimeve mbështetur në zbatimin e projekteve të financuar nga Bashkimi Europian, ku Këshilli i Qarkut zbatimin e këtyre projekteve që përmendëm më lart. Gjithashtu me vendim të Këshillit të Qarkut në vitin 2018 filloi zbatimin e këtyre projekteve në 4 Bashkitë të Qarkut me një fond prej rreth 14 milion leke. Këto objekte janë në fazën e përfundimit dhe marrjes në dorezim. Edhe në PBA 2020-2022 Këshilli


i Qarkut ka planifikuar fonde per pjesemarje ne Projekte ne bashkepunim me Bashkite e qarkut per permiresimin e infrastruktures ne sherbim te komunitetit. Ne total fondi per investime kap rreth 35.5 % te buxhetit per tre vitet e ardhshme.

- Shpenzimet për personelin, parashikimi u bë në mbështetje të numrit të punonjësve të planifikuar me ligj, shpenzimet për paga dhe sigurime zënë 39% të buxhetit.
- Në parashikimin për shpenzime operative u mbështetëm në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara dhe parashikimin e shpenzimeve administrative më të domosdoshme për funksionimin e Institucionit. Shpenzimet operative zënë 25% të buxhetit.

Ky program buxhetor afatmesëm, është i balancuar (të ardhurat =shpenzimet).

Kryetar i Këshillit të Qarkut

Ana VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

**RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMITTE BUXHETIT TE VITIT 2019
PER PERIUDHEN 4/MUJORE**

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 48 "Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor" paraqitim Këshillit të Qarkut "Raportin për monitorimin e zbatimit të buxhetit të vitit 2019 për periudhën 4/mujore"

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2019 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*
- *Ligjin nr.68 /2017"Per financat e vetqeverisjes vendore"*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008" Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 99/2018" Për buxhetin e vitit 2019"*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.9 datë 20.03.2018."Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit"*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomise nr.1 dt 17.01.2019 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019".*
- *Në Vendimin e Keshillit të Qarkut nr.13 date 11.12.2018 "Per miratimin e buxhetit të Keshillit të Qarkut per vitin 2019"*

Raporti paraqet punën e administratës të Këshillit të Qarkut Korçë në zbatimin e politikave të percaktuara nga Keshilli i Qarkut si në realizimin e burimeve të ardhurave ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësive të shërbimeve të ofruara. Ai përqëndrohet kryesisht në veprimet e ndërmarra dhe arritjet në realizimin e të ardhurave nga tarifatat vendore, si dhe në menaxhimin dhe administrimin sa më të mirë të shpenzimeve për periudhën vjetore 2019.

CILI ËSHTË MISIONI I QARKUT KORÇE

Misioni i Këshillit të Qarkut Korçë është hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale, harmonizimi i tyre me politikatat e qeverisjes qendrore në plotësim të funksioneve të veta ligjore, si dhe çdo funksion tjetër i dhënë me ligj. Këshilli i Qarkut ofron bashkëpunimin dhe koordinimin midis qeverisjes qendrore dhe qeverisjes vendore, si dhe bashkëpunimin e koordinimin e politikave midis njesive të qeverisjes vendore të rajonit.

Këshilli i Qarkut Korçe ofron partneritet, koordinim dhe mirëkuptim midis të gjithë partnereve lokale e rajonale për pjesëmarrje në projekte gjithëpërfshirëse. Këshilli i Qarkut ofron partneritetin e tij për pjesëmarrje në Programet nderkufitare të financuara nga Bashkimi Europian, etj. me synim zhvillimin ekonomik social të Rajonit dhe rritjen e cilësive të shërbimeve për komunitetin.

OBJEKTIVAT E KËSHILLIT TË QARKUT PËR VITIN 2019

Disa nga objektivat kryesore të Këshillit të Qarkut për vitin 2019

- Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.
- Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçe.
- Pjesëmarrja në Programet nderkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.
- Nxitjen e bashkëpunimit midis njësive të qeverisjes vendore të Rajonit, si dhe bashkëpunimin nderrajonal.
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.
- Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njësive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit Europian.

REALIZIMI I BUXHETIT TË KËSHILLIT TË QARKUT PËR PERIUDHËN 4/Mujore 2019

Zbatimi i Buxhetit të Këshillit të Qarkut për periudhën 4/mujore 2019 ka ecur në kushte normale, kjo si rezultat i një planifikimi të mbështetur mbi burime reale të të ardhurave të vete Institucionit si dhe një menaxhim të mirë të shpenzimeve në funksion të realizimit të aktiviteteve dhe programeve të planifikuara për këtë vit.

Burimet e financimit :

- Të ardhurat e vetë Institucionit
- Transferta e Pakushtëzuar (Granti)
- Transferta e Kushtëzuar

Funksionet kryesore të strukturave financiare :

- Për funksionet e veta
- Për funksionet e përbashkëta
- Për funksionet e deleguara

➤ Analiza e realizimit të të ardhurave për periudhën 4/mujore

Të ardhurat e veta për vitin 2019 janë parashikuar sipas metodës dinamike duke marrë në konsideratë të dhënat e ecurisë së arkëtimit të viteve të fundit, dhe realizimit faktik të vitit 2018.

~~Llojet e të ardhurave që ka arkëtuar institucioni gjatë periudhës kanë qënë si mëposhtë:~~

- Të ardhura nga tarifat e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut ne funksion te sherbimeve qe ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2018, të cilat janë planifikuar te perdoren per financimin e shpenzimeve te planifikuara per kete vit buxhetor

Gjate kesaj periudhe Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh nje balance te drejte midis burimeve te financimit dhe realizimit te shpenzimeve ne permbushje te aktiviteteve dhe programeve te miratuara per vitin 2019.

Te ardhurat ne buxhetin e Keshillit te Qarkut per kete periudhe jane realizuar si me poshte:

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani viti 2019	Plani 4/mujor	Fakti 4/mujor	Realizim ne %
1. Transferta e pakushtezuar	52551	22205	22205	100
2. Te ardhurat e veta	7800	200	181	90.5
a. Te ardhura nga tarifat	1800	200	181	90.5
b. Kontributi financiar i bashkive	6000	0	0	0
3. Te ardhura te trasheguara 2018	46159	46159	46159	100
4. Transferta e kushtezuar	6715	2353	2353	100
Totali 4/mujor	121587	121587	116657	95.9

Transferta e pakushtezuar vazhdon te jete burimi kryesor i te ardhurave dhe eshte perdorur per financimin e funksioneve te veta ne mbeshtetje te legjislacionit ne fuqi.

Realizimi i te ardhurave te vete institucionit per 4 mujorin e pare eshte ne nivelin 90.5 %, por krahasuar me plenin vjetor per kete periudhe jane realizuar vetem 2.3 % te te ardhurave. Per kete 4 mujor jane planifikuar vetem te ardhura nga tarifat e sherbimeve qe ofron Keshilli i Qarkut. Te ardhurat nga kontributi i bashkive jane planifikuar ne periuidhen ne vazhdim.

Te ardhurat e trasheguara nga viti 2018 ne total jane ne vlere 74 milion leke leke (grant + te ardhura), por per katermujorin e pare jane planifikuar vetem 46 milion. Diferenca do te planifikohet ne buxhet per periudhen ne vazhdim. Keto fonde jane ne nivele te larta dhe jane krijuar gjate tre viteve te fundit, pasi Institucioni ka planifikuar fonde te mjaftueshme per financimet e 15 % te pjesemarjes ne buxhetet e Projekteve te fituara nga Programet IPA CBC 2014-2020 si dhe fonde te mjaftueshme per parafinancimet. Implementimi i ketyre projekteve filloi gjate vitit 2018 dhe financimi i tyre do te jete ne dy vitet ne vazhdim.

Te ardhurat e realizuara ne total jane perdorur per financimin e funksioneve te veta te percaktuara si me poshte:

- Pagat e personelit,
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit.
- Për shpenzime operative
- Investime
- Bashkefinancim Projekte te BE
- Investime ne infrastrukture sipas propozimeve te bashkive dhe miratimit ne Keshillin e Qarkut

Te ardhura nga fondet e kushtezuara per periudhen vjetore 2019

Gjatë vitit 2019, Këshilli i Qarkut për përmbushjen e funksioneve të deleguara, ka përfituar nga buxheti i shtetit fonde të kushtëzuara, buxhetore për shpenzime në shumën prej **6715 mije lekë**, nga e cila 2353 mije leke janë plani për 4/mujorin e parë. Realizimi i tyre për këtë periudhë është 1838 mije leke ose 78.2 %. Këto fonde janë përdorur për financimin e aktivitetit të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes në Qark e cila është funksion i deleguar. Ky akordim është kryer në mbështetje të programit fillestar të buxhetit të shtetit.

➤ Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën 4/mujore

Shpenzimet e buxhetit gjatë gjatë 4/mujorit janë realizuar në shumën prej **18322 mije lekë** ose e shprehur në përqindje **30 %** ndaj planit të periudhës prej **61787 mije leke**.

Nga totali i shpenzimeve për periudhën 4/mujore, shpenzimet korrente janë realizuar në shumën prej **14797 mije leke** ose **46.76 %** ndaj planit prej **31648 mije leke** sipas programeve të miratuara për administratën e keshillit të qarkut dhe drejtorinë e DAMT në qark. Mosrealizimi lidhet me financimet në nivelin zero të shpenzimeve për Projektet, pasi ato janë në fazat e prokurimeve.

Shpenzimet kapitale për periudhën 4/mujore janë realizuar në vlerë **3525 mije leke** ose **11.74 %** të planit prej **30039 mije leke**. Për këtë periudhë janë financuar 100% dy objekte të miratuara nga Këshilli i Qarkut me fonde të vetë institucionit. Një objekt në Bashkinë Erseke me fond 1932 mije leke “Rikonstruksion Catia e Cerdhës të femijëve Erseke” dhe një objekt në Bashkinë Korce me fond 1513 mije leke: “Nderhyrje pjesore në infrastrukturën rrugore fshatrat Ravonik dhe Floq”. Gjithashtu është financuar “Pajisje për ngrohje ambjenti me vlerë 80 mije leke. Shpenzimet kapitale të planifikuara në Projektet e Bashkimit Europian janë në proces prokurimesh dhe financimi i tyre do të jetë në periudhën në vazhdim.

Realizimi i Shpenzimeve për 4/mujorin e parë paraqiten si më poshtë

Ne 000/leke

Nr.	Emertimi sipas Programeve	Plan	Fakt	Diferenca	% realizim
1	Administrata – Programi 01110	33970	15862	18108	46.7
	Paga personeli	7410	4358	3052	58.82
	Sigurime shoqërore e shëndetësore	1200	707	493	58.92
